



KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 001/060 – 138243

Më: 29 tetor 2024

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 29 tetor 2024, në Sallën e mbledhjeve të KPF-së, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në ora 10:15 minuta.

Pjesëmarrës nga KPF-ja, ishin: Antigona Bytyqi, Kryesuese e KPF-së, Karanfil Haxhillari, Dafina Alishani, Adem Shabanaj, Naxhije Memaj Florent Ukaj, Egzona Hoxhaj Levent Buş dhe Bajram Kastrati, të gjithë anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pjesëmarrës tjerë ishin: Kujtim Gashi, Nënkryetar i Komunës, Luljeta Veselaj Gutaj nga DASH, Halil Likaj nga DEF, Mybexhele Zhuri nga Zyra për Barazi gjinore dhe të Drejtat e Njeriut dhe Gursel Skenderi nga Sektori i Pronës, si dhe OJQ-të e Mediat.

Antigona Bytyqi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, i nderuar Nënkryetar, zyrtar të drejtorive, media dhe gjithë ju të pranishëm, përshëndetje. Për sot siç jeni të njoftuar me kohë e kemi thirrur mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent jemi nëntë anëtarë, pra të gjithë jemi prezent dhe mund të vazhdojmë me punimet e kësaj mbledhje. Për rend dite kemi paraparë këto pika:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të datës 10 shtator 2024 (mbledhje e jashtëzakonshme) dhe 24 shtator 2024 (mbledhje e rregullt);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për kursimin dhe ridestinimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullores për dhënien e dekoratave nga komuna e Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për barazinë gjinore (2024-2026);
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.001/011-95083 të datës 18.07.2024;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. 001/011-14771 të dt. 27 janar 2022, sipas Rekomandimit të Komitetit për Komunitete;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2025-2027;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Komisionit Përzgjedhës (DKA);
10. Raporti financiar janar – qershor dhe janar-shtator 2024;
11. Diskutim rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Prizrenit për vitin 2023 dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2023;
12. Informatë rreth raportit të punës të Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), për periudhën janar-gusht 2024;
13. Raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Qendrës Historike të Prizrenit për periudhën gusht 2023- qershor 2024;
14. Informatë rreth përfundimit të vitit shkollor 2023/2024 dhe informatë rreth fillimit të vitit të ri shkollor 2024/2025;
15. Raporti i Performancës Komunale për Komunën e Prizrenit, për vitin 2023.

Po fillojmë menjëherë me pikën e parë.

Pika e parë:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të datës 10 shtator 2024 (mbledhje e jashtëzakonshme) dhe 24 shtator 2024 (mbledhje e rregullt);

Antigona Bytyqi: Sa i përket procesverbaleve a ka dikush diçka me shtuar? Në qoftëse nuk kemi, atëherë po i hedhi në votim. Prezent jemi nëntë (9) anëtarë, kush është për? Unanimisht, ju faleminderit. Kalojmë te pika e dytë.

Pika e dytë:

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;

Antigona Bytyqi: A ka dikush diçka me shtuar rreth rendit të ditës? Po Karanfil urdhëro.

Karanfil Haxhillari: Faleminderit, përshëndetje për të gjithë. Po i vërej që neve seancën e fundit disa pika të rendit të ditës kanë qenë pika të cilat kanë qenë të pashqyrtume dhe seanca e ndërpreme edhe të cilët qenkan inkorporuar këtu. Pra, disa nga pikat e rendit të ditës, kjo është një seancë e re kuptohet, por që me të vërtetë e paskan ngarkuar seancën e 31 tetorit me 15 pika të rendit të ditës. Edhe pse konsideroj që disa prej pikave edhe me një mirëkuptim kishim mund me e zbutë pak. Për shembull, disa nga pikat për projekt-rregullorin e dekoratave, nuk është ndonjë urgjencë, sa janë urgjencë pikat tjera, për shkak që me të vërtetë në 15 pika interesimi i kuvendarëve po bjen edhe nuk po ka interesim për pikat të cilat me të vërtetë që disa herë po vijnë me raportuar, si këta të Këshillit për Trashëgimi Kulturorë si të barazisë gjinore si të financat dhe si performance si krejt. Kështu që ish kanë mirë disa me e lehtësuar këtë seancë, me disa pika, nuk e din, tash për shembull pika e propozim-vendimit për kursimin dhe ridestinimin e mjeteve. a ka afate ligjore kjo? Në qoftë se ka afate ligjore okay, le të mbetet, por për këto të tjerat, unë kisha thënë disa me i hjek edhe me e zbutë këtë. Edhe tjetra është, mos ndoshta kemi konflikt në qoftë se pikat e një seance të mbetur, a s'do të kishte qenë më mirë për shembull vazhdimi i seancës ku ka mbetur dhe më pastaj seanca e re? Apo ndoshta jo e rregullt mundet të mbetet në qoftë se bëhet në këtë formë qysh e keni bërë.

Antigona Bytyqi: A ke propozime konkrete për cilat pika?

Karanfil Haxhillari: Jo për shembull ato pikat që kanë mbetë seancën e kaluar, vazhdimi i seancës të kaluar dhe në të njëjtën kohë pastaj me pikat e reja të rendit të dikes, është edhe më ligjore mesa e di unë. Duke pas parasysh faktin që kemi mbet në gjysmë nuk janë konsumuar, nuk janë përfunduar ato pika për me vazhduar me pika të reja.

Antigona Bytyqi: Veç të njëjtën seancë a e ke fjalën, veç bartja, renditja për renditje a e ke fjalën? Tash i kemi për shembull këtu një dy, tre pika, po më duket të reja, vetëm tre pika janë të reja, nëse s'janë gabim> E kemi shqyrtimi dhe miratimi i project-rregullores për dhënien e dekoratave, edhe kjo ridestinimi i mjeteve edhe i kemi komitetin për komunitete edhe të arsimit planin e kemi, po pikën e tetë edhe e kemi, project-plani zhvillimor komunal i arsimit. Domethënë për katër pikat e reja po thu që me i largu?

Karanfil Haxhillari: Ndoshta dhe jo me i largu ose me i largu me vazhdu, shihe ndoshta po bëjmë një. Tash realisht Kryesuese domethënë është përfunduar një seancë pa përfunduar dhe nuk është thirrë vazhdimi i seancës me pikat të cilat i kemi pasur në trajtim.

Antigona Bytyqi: Jo i kemi përfshi kur e kemi thirrë.

Karanfil Haxhillari: Po nuk janë përfunduar për shembull këto pika që keni qit këtu. Unë konsideroj që ajo seancë nuk ka përfunduar, unë e kam më tepër për shkak të jo ligjshmërisë që mundet nesër me na ndodhë. Në qoftë se nuk ka ndonjë jo ligjshmëri, atëherë vazhdojmë.

Antigona Bytyqi: Nuk është hera e parë që na i kem këto pika, kështu që ne e kemi thirr një mbledhje të rregullt, përsëri e thirrëm vazhdimin, nuk vazhdojë mbledhja dhe kështu që këto pika mbetën. Po Nënkrjetar, urdhëro.

Kujtim Gashi: Faleminderit kryesuese. Fillimisht po ju përsërites të gjithë anëtarë të komitetit, drejtoreshë, Mybexhele, Gursel. Veç për me e ndihmu pak. Është e vërtetë që 15 pika e keni problem me i kry me një seancë sepse ka vendime edhe raporte. Ndoshta kishte me qenë mire me i caktuar dy seanca dhe me përfunduar një në fund të këtij muaji edhe tjetrën diku nga fillimi i muajt të ardhshëm ose me mbetë pjesa e raporteve krejt me si opsion, për me ndihmuar. Edhe e dyta edhe pika për kursim edhe ridestinin është mbase e vonuar edhe duhet me e shty përpara për shkak se janë do kategori shumë të rëndësishme ku barten mjetet edhe në disa ku largohen mjetet. Tuj e pasur parasyshtë që çdo ditë përmbaruesi është duke vepruar edhe po e shihni që kanë telashe edhe komunat edhe ministritë me bllokim të llogarive, na duhet me e përfunduar si proces në këtë pike. Meqë sot kur po e mbajmë këtë komitet, drejtori është në Ministritë të Financave pikërisht për me i definu dhe këto çështjet problematike që janë me kontratën kolektive. Edhe e dyta rregullorja për çmime dhe dekorata është një proces që është përcjellë me një mbështetje të USAID-it edhe ata e kanë kërkuar me pas një datë të caktuar ku kanë vendosur me qenë pjesë e seancës. Nuk është mire me e larguar sepse meqë e kanë ndihmuar si proces, ata do të jenë dhe të pranishëm ditën kur kemi me shqyrtuar. Kështu që po mendoj që është punuar bashkarisht me ta dhe me një komision të veçantë të kuvendit të komunës edhe nuk kisha thënë që është mirë me largu, por nëse veç vendosni me e shqyrtu edhe njëherë këtë rend të dite me 15 pika, atëherë më mirë kishte me qenë ndoshta me shku deri te pika 8, pastaj me i lënë pikat tjera me një seancë tjetër edhe me i mbajtur dy seanca ngjitur njëra me tjetrën, la ndodhur edhe në të kaluarën kur janë caktuar dy seanca të rregullta afër njëra tjetrës. Këtë e pata krejt vetëm si propozim.

Antigona Bytyqi: Faleminderit Nënkrjetar. Dikush tjetër? Po urdhëro Dafina.

Dafina Alishani: Edhe unë mendoj që për hir të korrektësisë janë disa pika këtu të cilat kanë ardhur tre ose katër herë në kuvend dhe nuk kanë mundur me u diskutu, si raporti i Këshillit për Trashëgimi Kulturorë, performanca, këto të gjitha janë kanë disa seanca dhe nuk kanë pas mundësi me ardhë me raportu! Kam frikën që prapë kanë me ardhur në seancë edhe prapë nuk kanë me mujtë me raportu. Kështu që ndoshta në renditje me i bërë këto pikat të cilat kanë qenë shumë të përsëritura, me i qit në fillim edhe me e definu që me dy ditë seancë me me i kryer të gjitha. Por dekoratat mua pavarësisht që USAID qenka present, nuk mendoj që ka ndonjë urgjencë edhe mirë kish me qenë me e largu. Këto të tjerat. që kanë afate ligjore në rregull, por ideja është me qenë në kuvend edhe me u diskutuar secila pike. Nëse është tendenca me i futë shumë pika e mos me pas diskutim atëherë kjo i bie që po zbehet edhe roli i kuvendarëve. Prap po them, këto raporte të cilat disa here, nuk ka kuptim ma edhe prej zyrtarëve kanë ardhur diku katër herë nëse s'gaboj edhe më as nuk kanë vullnet as motiv me ardhur me raportu a janë sene shumë me rëndësi.

Antigona Bytyqi: Po ajo kishte me qenë mirë nëse mundem me thënë pikat më të vjetra që kanë ardhë disa herë me rend ditë por ju e dini që e kemi një rregullore edhe në bazë të rregullores renditja është bërë që raportet dhe informatat janë në fund. Por megjithatë ju po propozoni që të largohet pika e katërt. A ka propozime të tjera? Po Bajram urdhëro.

Bajram Kastrati: Faleminderit Kryesuese, përsëritet për të gjithë. Veç nëse vendosim t'i mbajmë dy seanca në një afat jo larg njëra tjetrës, unë kisha propozuar me shku prej pikës së parë deri në të 8-tën në një seancë edhe pjesën tjetër prej të 9-tës deri në të 15-tën, me shu seancën tjetër. Përderisa nëse veç e lejmë, seancat të jenë të përafërta kështu në afatin kohorë. Mos me hy

tash me i ngatërru e heqim këtë, e heqim atë tjetrën sepse veç i nxjerrim vetes punë edhe. Pa marrë parasyshë se a e lëmë prej të 9-tës deri të 15-tën atë tjetrën. Por masi veç janë në renditje, kisha propozuar që në seancën e pare të shkojmë deri në 8-tën pastaj prej të 9-tës, faleminderit.

Antigona Bytyqi: Faleminderit. Për mu hiç nuk ka problem, mundemi edhe si KPF, mundemi edhe me shefat e grupeve me e caktuar datën që të jetë dy ditore, kështu na ka ndodhur besoj e dini edhe në një seancë tjetër ku kemi pasur mbi 23 apo 24 katër edhe jemi dakorduar me shefat e grupeve që të jetë dy ditë. Po urdhëro Florent.

Florent Ukaj: Faleminderit Kryesuese. Edhe unë e mbështes propozimin e Dafinës se me të vërtetë nuk ka kuptim edhe prej zyrtarëve që i shohim shumë shpesh këtu edhe në fund kur vjen prapë dështon seanca. Unë nuk e kisha mbështetur propozimin e Bajramit ose Nënkryetarit, për shkak që me shku me renditje, me shkuar si më të vjetra që po i thojmë, me i kryer këto çka kanë mbetë. Qe sa seanca nuk po mundemi me i përfundu edhe pastaj me i dhënë prioritet këtyre të tjerave. Mendoj që më e drejtë dhe më e urdhës ish kanë që edhe për shkak të zyrtarëve që kanë edhe punë të tjera, sepse tash nuk bënë nëse ne sun mirremi vesh e këta me i munduar çdo séance. Ti japim rëndësi këtyre si më të vjetra që janë t'i kryejmë, t'i përfundojmë sepse po mbeten në fund prapë nuk kanë me përfunduar.

Karanfil Haxhillari: Jemi i sigurtë që pastaj në seancën e ardhshme për këto pika prap ka me pas pita të tjera jo.

Florent Ukaj: Jo por edhe nuk nuk i japin rëndësi seancës, po e shohim që shumicën e rasteve kur po ka raporte nuk po i japin rëndësi. Prandaj, unë kisha propozuar, duke e ditë që kemi edhe një rregullore, por besoj se ne si KPF e kemi të drejtën që mundemi me i ndryshuar pikat. Këto çka kanë mbetur më të vjetra me i qitë më në fillim edhe me mbajtë seancën të enjtën.

Bajram Kastrati: Do të thotë prej të 9-tës deri në të 15-tën?

Florent Ukaj: Jo prej të 9-tës, por me I këqyr cilat janë më të vjetra

Bajram Kastrati: Po thu prej të 9-tës me e qitë ditën e pare?

Florent Ukaj: Jo të 9-tën me e qitë pike e pare, si raporti financiar për shembull.

Antigona Bytyqi: Pikat që kanë ardhur disa here, vetëm renditjen me ndryshuar apo?

Antigona Bytyqi: Qekjo ideja në dy pjesë mire, por prap ju vendosni.

Kujtim Gashi: Veç edhe pak nëse bënë për me ndihmu. Tek renditja me i qitë të parat raportet përpara vendimeve, bini ndesh me rregulloren. Që doni me i bë dy seanca e me i shqyrtu veç këto raportet ditën e parë, është ok. Por, përpara vendimit smun i qesish raportet sepse bënë shkelje të rregullores, sepse e ke përcaktuar njëherë vendimet pastaj informatat edhe raportet në rregullore të punës së kuvendit.

Dafina Alishani: Po çfarë nëse KPF-ja merr vendim?

Bajram Kastrati: Nëse bëhen dy seanca, atëherë duhet me përcjellë afatin.

Kujtim Gashi: Mundeni me e caktuar sotë ditën menjëherë, është në dorën e juaj kjo punë.

Karanfil Haxhillari: A ta bëjë një propozim konkret.

Kujtim Gashi: Veç edhe një lutje e kam. Çdo propozim që e bëni konkret, ridestinimin duhet me ditë që duhet me pasë prioritet.

Dafina Alishani: Kërkush se përmendi atë, po ju lajmë, pro dekoratat nuk kanë urgjencë ajo.

Kujtim Gashi: Pajtohna, e thash për aspekt pak më shumë solemn. Nëse mendoni që USAID e nderon Kuvendin.

Karanfil Haxhillari: Ok, po shkojmë me numra, s'po i lexoj. E lëmë 3-shin, pastaj plani i veprimit për barazi gjinore disa herë u kanë, domethënë 5-shin, pastaj këtë anëtarin e komisionit vlerësues po më duket u kanë, 6-shin, 7-shi, Komiteti për Komunitete është e re.

Antigona Bytyqi: Po edhe e 8-ta është e re, pika e 9-të nuk është.

Karanfil Haxhillari: Po 9-shin, pastaj vazhdojmë krejt teposhtë, a po i bjen kështu.

Antigona Bytyqi: Këto pikat e reja që kanë ardhë për herë të pare>

Karanfil Haxhillari: Në vazhdimin e seancës së re.

Egzona Hoxhaj: Si me u thirrë dy seanca si me u mbajtë një seancë me vazhdim. S'po e di pse duhet me i caktu dy data prej sodit, p.sh. kemi me i mbajtë dy seanca!

Adem Shabanaj: Ndoshta mundemi me i përfundu.

Egzona Hoxhaj: Po de si dihet, ndoshta mundemi me i përfundu.

Florent Ukaj: Për shkak të rregullores na tash s'po mujna.

Egzona Hoxhaj: Ashtu ashtu vazhdimi thirret për të hënë direkt.

Kujtim Gashi: Me thirrë séance të re, sepse në vazhdim s'po vijnë sepse s'po paguhen, këtu po është problem.

Dafina Alishani: Nëse nuk nuk bëhet me renditje në ndryshim, atëherë s'ka s'ka arsye pse me ndërru këtë rend dite. Nëse raportet edhe këto që janë ripërsëritë disa herë nuk dalin në fillim mas pyetjeve – përgjigjeve, atëherë pe lëjmë kështu edhe s'ke çka.

Antigona Bytyqi: Jo mas pyetjeve-përgjigje se ka pika që kanë ardhur këto ditë, për shembull këto që i përmendi Karanfil, shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal të veprimit për barazinë gjinore, janë bashk këto.

Karanfil Haxhillari: Po janë shqyrtime që i kemi pasur edhe në seancat e kaluara për që s'kanë kaluar.

Antigona Bytyqi: Po, përveç këtyre katër pikave.

Bajram Kastrati: Nëse shkojmë dy seanca veç e veç, atëherë pika pyetje dhe çështje duhet në dy seancat.

Antigona Bytyqi: Me vazhdim s'po na vijnë, kështu që.

Karanfil Haxhillari: Ideja ime ke me e lehtësu seancën edhe me pas efektivitet. Ndryshe po ka efekt me pesë apo gjashtë pika të rendit të ditës, ndryshe me 15-të.

Florent Ukaj: Këto raporte na kanë mbetë që sa kohë, është mire këto raporte me i përfundu, me lënë veç një pike që është më e rëndësishme, si p.sh. ridestinimin e mjeteve edhe me shku krejt me raporte çka kanë mbetë, të tjerat me shku me seancën tjetër.

Bajram Kastrati: Lenti, ama nëse e lënë të enjtën seancën me vazhdu me raporte të premtën s'qon pesh kjo.

Antigona Bytyqi: Po propozojnë me i hjek të tjerat.

Florent Ukaj: Jo jo, veç qekjo mu lane, shqyrtimi dhe miratimi prozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve dhe me vazhdu menjëherë me raporte tani. Pyetje-përgjigje pika e tretë edhe raportet me vazhdu. Këto pikat e tjera me i lënë për seancat tjetër. Apet shumë po mbesin 10-të pika, sepse me i lënë krejt raportet apet deshtojnë.

Bajram Kastrati: Ama a me lënë vazhdim apo me e lënë të re?

Florent Ukaj: Jo bre me e lënë séance të re.

Bajram Kastrati: Qatë që cili është prpozimi me e ditë.

Egzona Hoxhaj: Shkon kohë.

Florent Ukaj: Pse shkon kohë? Ti mundesh menjëherë me thirrë séance.

Kujtim Gashi: Të enjtën pasdite nëse doni mundeni me e thirrë edhe javën tjetër e ke gati.

Antigona Bytyqi: Më dhatë shumë propozime, po shkojmë kështu me radhë. Propozimi i parë po pati propozim edhe që ndahet në dy pjesë, deri te pika tetë, pastaj me vazhdu me pikat nëntë, domethënë njëra prej propozimeve është. Kush po pajtoheni me këtë propozim që të mbahen dy seanca.

Bajram Kastrati: 3,5,6 po bëjnë 3 pika, tani prej të 9-tës, 4,5,6,7,8, po na bëhen 10-të me një séance.

Dafina Alishani: Idea e Florentit ma e mire është.

Antigona Bytyqi: Edhe unë po pajtohem me atë, a po e qesim këtë në votim?

Bajram Kastrati: Mirë, veç a po shkojmë me séance të re apo me vazhdim?

Antigona Bytyqi: Me tÿ re, e kishim thirrë seancën e re. Materialet i kemi gati, të enjten ose të premtën e thirim, të shihim qysh e kemi mundësinë.

Bajram Kastrati: Mirë, tash me cilat pika po vazhdojmë.

Florent Ukaj: Pyetje-përgjigje, ridestinimi i mjeteve edhe raportet.

Antigona Bytyqi: Nëse i hjekim, ma të re e thirim. A po e qesim në votim që vetëm ridestinimi i mjeteve edhe prej pikes 10-të e teposhtë, pastaj e thirim një mbledhje tjetër. Kush është për, për këtë propozim? Unanimisht, ju faleminderit. Mbeten 1, 2, 3 edhe shkojmë 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15. Ju faleminderit, kalojmë te pika e tretë.

Pika e tretë:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për kursimin dhe ridestinimin e mjeteve buxhetore ne kategorinë ekonomike te investimeve kapitale;

Antigona Bytyqi: Zotëri Likaj, fjala për juve.

Halil Likaj: Faleminderit, përshëndetje për të gjithë. Faktikisht është vendimi për kursimin dhe ridestinimin e mjeteve buxhetore, ka korigjimi për shkak të përmbaruesit por totali nuk ka ndryshuar. Domethënë me vlerë totali është i njëjtë, vetëm ka korigjime për arsye që përmbaruesit kanë marrë do mjete.

Karanfil Haxhillari: Veç deshta me e ditë, tash në qoftë se kanë mbetë në DSHP qato kursime, e njëjta shumë a do të kalohet prapë në DSP apo tjetërku?

Halil Likaj: 918.000 është totali, shumica domethënë krejt janë andej, shëndetësia i ka 100.000 edhe arsimi i ka 144.075€, domethënë totali është 1.162.000.00€.

Kujtim Gashi: Kjo është prej 5% të investimeve, mungesë ku ka një pjesë, mungesa në projekte.

Karanfil Haxhillari: Këto propozime për me i delegu, për me i dërgu diku s'kemi hapësirë a?

Halil Likaj: Brenda drejtorisë më shumë kjo është.

Kujtim Gashi: Këta po i shihni se ku janë marrë edhe ku janë qitë. Nëse një propozim duhet të vendosë tash duhet me ditë ku i marr edhe ku i len?

Dafina Alishani: I marrë prej kësaj ku i ka planifikuar dhe i qes diku ku ka nevojë.

Kujtim Gashi: Duhet mu qu ku kanë nevojë drejtoritë që i kanë bërë propozimet.

Dafina Alishani: Jo, ne kemi edhe kërkesa të njerëzve, të qytetarëve të cilët kanë kërkesa, pse mos me i qit tash.

Kujtim Gashi: Cilat janë ato?

Dafina Alishani: Për shembull në Urbanizëm tek merementimi.

Kujtim Gashi: Mallëra është, kulmat a po thu?

Dafina Alishani: Po.

Kujtim Gashi: Mallëra është.

Dafina Alishani: Mirëmbajtja e korridoreve.

Kujtim Gashi: Ato domethënë s'i kemi, sot i kemi veç kapitalet.

Halil Likaj: Veç kapitale janë këto.

Kujtim Kashti: Mallërat i ridestinon kryetari me vendim brenda drejtorive, brenda kategorive. Domethënë kjo është veç për kapitale.

Dafina Alishani: Po mire, nëse e gjejmë një kod edhe propozojmë në kuvend?

Halil Likaj: Brenda drejtorisë domethënë më mirë është mendoj, këta të tjerët ashtu ashtu s'kanë kërkuar, këta tre drejtori i kanë kërkuar. A ju në qoftëse keni diçka, atëherë ju mund të propozoni në kuvend.

Dafina Alishani: Po a është propozimi, prej drejtorisë në drejtori duhet me qenë apo mundet prej DSHP-së dikah tjetër, qysh është?

Halil Likaj: Po standart po shkon nëpër drejtori, për shembull në shërbime shëndetësia i ka 100.000 të mbetur i qetë prapë me një kod tjetër të shëndetësisë. Arsimi e ka të mbetur që kanë mbet prej projekteve apo nuk realizohet një project, prapë shkon në arsim. Edhe DSHP-ja ka të veta që i destinon në projektet ku ka nevojë.

Dafina Alishani: E këto a janë keq klasifikime apo?

Halil Likaj: Jo jo, për shembull ka mbetje edhe ka projekte që nuk po mund të realizohen, jo DSHP, jo arsye tjetër. Faktikisht mos me mbetë mjete, 5% për me shfrytëzë është momenti që domethënë të destinohen në projekte të tjera.

Bajram Kastrati: Megjithatë ne ke mundësi nëse e gjejmë një projekt konkret edhe me dhënë një propozim?

Halil Likaj: Po projekti duhet i planifikuar me qenë.

Kujtim Gashi: Ta kemi parasyshë, jemi në dy muajt e fundit, nëse zakonisht pse bëhet 5%? Aty ku ka mbetje dhe ku ka mungesa domethënë plotësohet, kjo varet prej zhvillimit të procedurave tenderuese. Diku me një projekt i ka të planifikuara 200 mijë, po projekti është fituar me 150 mijë, aty janë 50 mijë tepricë edhe barten me një projekt ku ka mungesa. Për me bërë këtë lëvizje, ti duhet me ditë a realizohet ai projekt se përndryshe ato shkojnë në suficit.

Bajram Kastrati: Po mirë tash ndërtimi i çerdhës në lagjen Arbanë. Unë dyshoj që ka me u realizuar, aty po thotë nuk pritet të implimentohet. Mirë e ku barten këto mjete?

Kujtim Gashi: Në shërbime publike.

Bajram Kastrati: A barten të një projekt konkret?

Karanfil Haxhillari: Të shkruan për secilin, ose konkret p.sh. ndërtimi i ashensorit te Motrat Qiriazit.

Kujtim Gashi: Të shkruan këtu, për secilin e ke. Ka raste kur 100 mijë i merr edhe i ndanë në 3-4 projekte kah 10-20 mijë.

Bajram Kastrati: Qartë, si totale po, por ama ti tha barten me një project tjetër konkret por këtu s'është i cekur.

Adem Shabanaj: Të drejtorisë së njëjtë.

Bajram Kastrati: Drejtorja tani vendosë ku i çon masanej..

Adem Shabanaj: Po, ku i qon, në cilin projekt. Mundet prej 27 mijëve këtu që janë të kësaj çerdhe mundet 10 mijë me i qu këtu e 17 mijë diku tjetër.

Kujtim Gashi: Për me të njoftu, hala ka mungesa nëpë projekte, por vetëm këtë shumë mundesh, ki të drejtë veç 5%. Neve po na duhen nja 7-8 milion.

Bajram Kastrati: Po, ndërtimi i çerdhes e mora si shembull, nëse këto 27 mijë e 700 tërhiqen, këtu nuk po e cek se ku kan me shku vetëm brenda drejtorisë, tash drejtoria vendos ku ka me i çu këto?

Kujtim Gashi: Po.

Bajram Kastrati: Ne s'kemi të drejtë me propozu me naj.

Kujtim Gashi: Të drejtë ki, duhet me kanë shumë konkret edhe me koordinu me drejtorinë përkatëse se duhet me ditë, duhet me indentifiku se a është projekti tuj u realizuar edhe ku ka mbërri.

Dafina Alishani: E mire, a s'po bën neve me na tregu ku destinohen këto? Ne po dojmë me ditë çka jena tuj votu.

Kujtim Gashi: Ju tregojmë unë në kuvend krejt, cent për cent.

Dafina Alishani: Jo me listë me na dorëzuar paraprakisht.

Kujtim Gashi: Po i keni me listë, shiko ndërtimi i objektit shkollor në Pllanjan, fundi i projektit kaç kaç në vlerë prej kaç kaç të mbetje nga planifikimi.

Dafina Alishani: Ku po i qojmë këto.

Kujtim Gashi: Qe në fund e ke ku kanë me shku. Neni tre, ridestinimi i mjeteve buxhetore në vlerë prej kaç, kaç, ndërtimi i shkollës projekt, kodi kaç, krejt janë me centa.

Dafina Alishani: Ok por na nëse kemi kod të caktuar të cilin është tu punu, mundemi me propozu a? Ashtu vijmë me një propozim konkret në kuvend. Edhe çfarë është ky digjitalizimi i shërbimeve të analizave laboratorike?

Halil Likaj: Shëndetësia, projekti i shëndetësisë.

Dafina Alishani: Këtë e bënë niveli qëndror, pse ka nevojë për pas tender?

Karanfil Haxhillari: Ama e kanë ndjek këtë projekt 100 mijë euro.

Dafina Alishani: Kjo është e ministrisë, s'ka nevojë me bë komuna.

Kujtim Gashi: Për qeta që s'ka nevojë i kanë tërhyjek mjetet, i kanë bartë.

Dafina Alishani: Edhe e udhës ish kanë me shku me propozime të kuvendarëve kush ka.

Halil Likaj: Domethënë ju këtu e keni se nga është marrë edhe në nenin tre e keni ku janë bartë.

Bajram Kastrati: S'po e shoh se ku janë bartë.

Halil Likaj: Te neni 3.

Bajram Kastrati: Mirë veç pak, qekjo 5449.

Halil Likaj: Jo jo kadale, totali 144 mijë në arsim, 43 mijë është bartë në Motrat Qiriazhi edhe në lagjen Tusus 100 mijë e 200€.

Bajram Kastrati: Veç deshta me e qartësu se a kemi apo s'kemi mundësi me propozu.

Kujtim Gashi: Të drejtë keni me bë propozime sepse në fund të fundit kuvendari e voton, por duhet me ditë mire me detaje se qysh janë duke u zhvilluar punët.

Antigona Bytyqi: Ju faleminderit. A ka dikush tjetër diçka? Në qoftë se jo po e hedhi në votim. Prezent jemi nënt anëtarë, kush është që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme kjo pikë? Unanimisht ju faleminderit shumë. Kalojmë te pika e dhjetë, raporti financiar janar qershor dhe janar shtator 2024. Këto pika të cilat i kanë prezantuar, jemi dakorduar që nuk ka nevojë edhe njëherë. Kështu që po e hedhi menjëherë në votim. Kush është për që t'i rekomandohet mbledhjes së ardhshme? Unanimisht, faleminderit. Pika e 11-të kush është për? Unanimisht, ju faleminderit. Pika e 12-të? Unanimisht, faleminderit. Pika e 13-ta? Unanimisht faleminderit. Pika e 14-ta? Unanimisht, faleminderit. Pika e 15-ta? Unanimisht, ju faleminderit. Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrje edhe shihemi mbledhjes e së enjtes.

Përfundoi në ora: 10:46 minuta.

